

## “CTS” SH.P.K

### AKT THEMELIMI I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “CTS” SH.P.K

Me vullnetin tim të lirë, të shprehur edhe me nënshkrimin e këtij akt-themelimi në cilësinë e Ortakut të Vetëm themelues, Unë; **Z. ÇETIN TALAT MUCUK**, i biri i Osman dhe Fikriye, shtetas turk, lindur në Tarsus / Turqi, më 27/05/1992, mbajtës i pashaportës së Republikës së Turqisë me nr. U27492360, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

krijoj sot më datë 06/01/2024 shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “CTS” SH.P.K me akt themelimi si vijon:

Akt Thmelimi i shoqërise tregtare “CTS” SH.P.K është i mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

#### Neni 1

##### Forma dhe emri i shoqërisë

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “CTS” SH.P.K. Shoqëria do t’i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t’i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

#### Neni 2

##### Selia e Shoqërisë

Selia e shoqërisë “CTS” SH.P.K do të jetë në adresën: **Lagjja Nr. 13, Rruga Pavarësia, Nd. 4, Nr. 10/41, Plazh, Durrës**. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë sipas parashikimeve të Statutit.

#### Neni 3

##### Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

- Aktivitete dhe agjensi të udhëtimeve turistike, organizime të udhëtimeve, pushimeve ose guidave tursitike individuale dhe kolektive, ose ndërmjetësimin për shitjen e produkteve të këtij aktiviteti, rezervimi i vendeve në mjetet e transportit të udhëtarëve, marrja dhe vënia në dispozicion me qira totale ose pjesërisht e këtyre mjeteve të transportit, rezervimi i dhomave në hotelet turistike, porositja e të ngrënit në restorantet turistike, dorëzimi i bonove të rezervimit dhe të porositjes ne mjetet e transportit, hotele dhe restorante; Shërbime të lidhura me pritjen turistike, si organizimi i vizitave në qytete, muze, monumente etj, shërbimi i guidëpërkthyesve, shoqëruesve; në dhënien e informacioneve për udhëtime e turizëm, të programuara paraprakisht ose sipas dëshirës së klienteve. Shërbime transport turistik, organizimi i udhëtimeve për turistët me mjete të të tretëve apo të vetë shoqërisë, Konsulenca në këtë fushë dhe në fusha të tjera, gjetja,

## “CTS” SH.P.K

menaxhimi dhe shpërndarja e personelit specialist në fusha të ndryshme, trajnimi dhe konsulenca për menaxhimin, aktivitete të tjera të burimeve njerëzore.

- Hapje dhe menaxhim të aktiviteteve të ndryshme shërbimi si hotele, Bar – Kafe, Restorante, Bujtina, etj. Si dhe shërbime akomodimi në struktura akomoduese si hotel, motel, hostel, bujtina e të ngjashme. Tregti me pakicë e shumicë, import – eksport të çdo lloj malli e produkti, përfshirë edhe mallrat e akcizës si cigare, duhan, alkool të të gjitha llojeve. Shoqëria mund të kryejë me qëllim arritjen e objektivave të biznesit të shoqërisë, çdo veprim tregtar, industrial, financiar dhe transaksion në lidhje me pasuri të luajtshme e të paluajtshme të cilat janë të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektivave të Shoqërisë.

Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve sipas kushteve për ndryshimin e Statutit.

### Neni 4

#### Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

### Neni 5

#### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë “CTS” SHPK është i përbërë nga Kontributi në Para, vlera totale e të cilit është **100.00 (njëqind) lekë**. Numri i Pjesëve, Kuotat e Pjesëmarrjes së Ortakut të Vetëm dhe Vlera e Kontributeve, të cilat paraqiten si më poshtë:

#### Ortaku i Vetëm themelues ÇETIN TALAT MUCUK:

- Numri i pjesëve : 1.00 (një)
- Kuota e pjesëmarrjes : 100.00 % (njëqind përqind) kontribut në para
- Vlera e Kontributit : 100.00 (njëqind) lekë

Kontributi i Ortakut të Vetëm mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

### Neni 6

#### Drejtimi i Shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga Administratori i saj, **Z. ÇETIN TALAT MUCUK**, atësia Osman, shtetas Turk, i pajisur me pashaportën e Republikës së Turqisë, me nr. U27492360, i lindur në Tarsus / Turqi dhe banues në adresën Rr. Plazhit, Lagja Nr. 13, Durrës.

Administratori është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme. Specimenti i nënshkrimit

:





## “CTS” SH.P.K

---

### Neni 7

#### Fitimi

Fitimi do të ndahet në bazë të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë..

### Neni 8

#### Vendimet e Shoqërisë

Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, i cili është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë, që ka të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj.

### Neni 9

#### Zgjidhja e konflikteve

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar, pranë Gjykatave kompetente të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 10

#### Vula e shoqërisë

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

### Neni 11

#### Rregjistrimi i Shoqërisë

Për rregjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personi i autorizuar do të pajiset me Prokurë të Posaçme nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.

*Akti i themelimit u përpilua në 3 (tre) kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente, ndërsa 1 (një) kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “CTS” SH.P.K.*

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

## Ortaku i Vetëm i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “CTS” SH.P.K

Z. ÇETIN TALAT MUCUK

Çetin Talat Mucuk

Përktheu nga gjuha shqipe në gjuhën turke:

Altin Kodra  
  


